



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 9 Mars 2023

Nr: 152

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË PUKË, PËR
RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 9 Mars 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Zj. Emirjona Përgjegjaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Pukë

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Pukë, për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 6.3.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike nga ana bashkisë Pukë.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

“Është zhvilluar sot ceremonia e dorëzimit të titullit “Qytetar Nderi”z. Bardh Doda, për të gjithë kontibutin e tij në fushën e arsimit, administrimit dhe menaxhimit të institucioneve të ndryshme shtetërore, ku spikat roli i tij në menaxhimin e situatave të emergjencave natyrore, menaxhimin e krizës së vitit 1997 dhe përballimit të fluksit të vëllezërve të ardhur nga Kosova në 1999”.

Link:

<https://www.facebook.com/100064645183888/videos/1385105819009912/>

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Më datë 6.3.2023, bashkisë Pukë i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 07.03.2023, ora 3:23 PM, bashkia Pukë bën me dije se: *“Në përgjigje të emailit tuaj lidhur me aktivitetin për dhënie titull Qytetar Nderi të z. Bardh Doda, ashtu siç shihet në postimin e dërguar, aktiviteti nuk është realizuar me datën 6 Mars 2023, por ditën e dielë me datën 26 Shkurt 2023. Eventu simbolik është organizuar nga familjarët e personit në fjalë dhe jo nga Bashkia Pukë, duke qënë edhe se Qytetar Nderi është një titull që akordohet nga Këshilli Bashkiak dhe jo nga Kryetari i Bashkisë, ndaj Kryetari i Bashkisë dhe të gjithë pjesëmarrësit e tjerë janë në cilësinë e të ftuarit në takim. Bashkëlidhur ju dërgojmë ftesën nga familjarët.”*

Në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se bashkia Pukë nuk është organizatore e aktivitetit të sipërpërmendur, për pasojë në referim të legjislacionit në fuqi, detyrimi për raportimin e aktivitetit nuk është mbi këtë institucion. Detyrimi për raportim është i institucioneve publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, të cilat duhet të raportojnë në Komisionin Qendror të zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Pukë, nuk përbën në shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor

Data: 9 Mars 2023 Nr: 152
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Pukë, për raportimin e veprimtarive publike”

dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj z. Emirjona Përgjegjaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Pukë.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI